

Qendra e Personel Rekrutimit kërkon të rekrutojë studentë ushtarakë për studime në Akademinë Ushtarake Modena, 2(dy) vende dhe në Akademinë e Forcave Ajrore në Pozzuoli, 1(një) vend. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë QPR është deri më datë 30 prill 2014.

1. Kriteret e pranimit të kandidatëve:

- Të ketë shtetësi shqiptare.
- Të ketë kryer shkollë të mesme brenda ose jashtë vendit, të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
- Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë.
- Të jetë në moshë jo më shumë se 22 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik.
- Të mos jetë i martuar.
- Të jetë i aftë nga ana shëndetësore.
- Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen.
- Të mos jetë bartës i virusit HIV dhe Hepatit B; të mos ketë kaluar sëmundje të zemrës, veshkave, mëlçisë dhe mushkërive.
- Kriteret e veçanta të pranimit që lidhen me gjatësinë trupore, peshën dhe moshën e kandidatëve, do të jenë sipas anekseve C, bashkëlidhur.
- Kandidatët që do të aplikojnë për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake në Itali të kenë notën mesatare të gjitha viteve të shkollës së mesme mbi 8.5 si dhe të kenë notën mesatare mbi 8.5 veças për lëndët, matematikë, fizikë, kimi.
- Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se zotërojnë diplomë për nivelin arsimor për të cilin aplikojnë.
- Nuk kanë të drejtë të regjistrohen për konkurrim ata kandidatë që e kanë fituar më parë statusin e studentit ushtarak.
- Kandidati i cili nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, atëherë ai s'kualifikohet.
- Tarifa e regjistrimit për konkursin e pranimit për vijimin e studimeve jashtë vendit për kandidatët që do të aplikojnë për arsimim të nivelit ushtarak universitar është 3000 (tremijë) lekë.

2. Dokumentet për regjistrim:

Kandidati për regjistrim duhet të paraqesë pranë Zyrës së Rekrutimit Tiranë këto dokumente:

- Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati, në të cilën të jenë të renditura 3 (tre) degët që dëshiron të ndjekë kandidati.
- Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar që vërteton përfundimin e arsimimit dhe notën mesatare.
- Certifikatë për TOEFL (nëse e ka).
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Certifikatë familjare 1 (një) copë.
- Fotografi për dokument, 2 (dy) copë.
- Dëshmi penaliteti.

- Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor.
- Vërtetim nga prokuroria që nuk është në proces hetimi.
- Raport mjekësor nga Spitali Ushtarak i Forcës Tokësore ku shprehet nëse kandidati është i aftë për të ndjekur studimet ushtarake jashtë vendit.
- Analiza e SIDA.
- Vërtetimet mjekësore se kandidati nuk është bartës i virusit HIV dhe Hepatit "B" dhe që nuk ka kaluar sëmundje të zemrës, veshkave, mëlçisë dhe mushkërive.
- Fotokopje e pasaportës së vlefshme për jashtë shtetit.

3. Datat e testimit:

- Testi Psikologjik, 05.05.2014.
- Testi Fizik, 06.05.2014.
- Testi i Gjuhës së Huaj, 07.05.2014.
- Testi Intelktual, 08.05.2014.

4. Të dhënat tabelore të Testimit të Aftësisimit Fizik:

| Disiplina / Pikë | Tërheqje në hekur | Qëndrim tërhequr në hekur | Kërcim nga vendi metra | | Hedhje topit basketbrolli në gjunjë (metra) | | Shpejtësi 10 x 25 metra | | Shtrirje - çuarje muskuj barku | |
|---------------------|----------------------|---------------------------------|---------------------------|--------|--|------|----------------------------|------|---|----|
| | Meshkuj | Femra | M | F | M | F | M | F | M | F |
| 6 | 16 | 60 " | 270 cm | 215 cm | 27 m | 16 m | 55 " | 65 " | 80 | 60 |
| 5 | 14 | 50 " | 260 cm | 210 cm | 26 m | 14 m | 57 " | 67 " | 72 | 55 |
| 4 | 12 | 40 " | 250 cm | 200 cm | 24 m | 13 m | 58 " | 69 " | 64 | 50 |
| 3 | 10 | 30 " | 240 cm | 190 cm | 22 m | 12 m | 59 " | 71 " | 58 | 45 |
| 2 | 8 | 25 " | 230 cm | 180 cm | 20 m | 11 m | 60 " | 73 " | 50 | 40 |
| 1 | 6 | 20 " | 220 cm | 170 cm | 18 m | 10 m | 62 " | 75 " | 45 | 35 |

Shënim: Testi Fizik është skualifikues. Konkurrenti (kandidati) për t'u kualifikuar në testin fizik duhet të grumbullojë mbi 30 % të pikëve.

5. Standardet e Peshës dhe Gjatësisë për Kandidatet që do të aplikojnë për studime në Akademitë e Forcave Tokësore, Detare dhe Ajrore në Itali për Vitin Akademik

Kriteri i gjatësisë për kandidatët e Akademive përkatëse

| Akademi e Forcave Tokësore | | Akademi e Forcave Detare | | Akademi e Forcave Ajrore | | Karabinieri | |
|-----------------------------------|-------|---------------------------------|-----------|---------------------------------|-----------|--------------------|-------|
| Meshkuj | Femra | Meshkuj | Femra | Meshkuj | Femra | Meshkuj | Femra |
| 1.65- | 1.61- | 1.65-1.95 | 1.65-1.95 | 1.65-1.90 | 1.65-1.90 | 1.70- | 1.65- |